



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 29

Datë: 02. 11. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Semnai, drejtoreshë u.d., e ZRPPC.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 27 dhe 28/2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të Planit të Punës së KQZ-së për periudhën Janar – shtator, 2022

- Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës gjinore dhe moshës së lidërshipt të partive politike 2017-2021
 - **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-Shtator 2022
-

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Mirë se keni ardh, po fillojmë me mbledhjen nr. 29 të KQZ. Pas paraqitjes së agjendës së mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalet nr. 27 dhe 28/2022 nga mbledhjet e KQZ-së.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, kryeshef i Sekretariatit, paraqiti një raport të punës dhe aktiviteteve më të fundit të sekretariatit. Fillimisht, ai tha se **KQZ** është duke vazhduar me hartimin e strategjisë 2023-2026. Tani, KQZ është në fazën e identifikimit të veprimeve strategjike që përfshin objektivat dhe aktivitetet strategjike. Lidhur me këtë, nën Grupi Punues për hartimin e strategjisë së KQZ-së 2023-2026, i përbërë nga Sekretariati, do të mbajë takim me datë 04 nëntor. Paraprakisht, dokumenti është kthyer në Sekretariat për të plotësuar me propozimet që përfshin veprimet strategjike dhe komentet, në mënyrë që dokumenti të fillojë të draftohet dhe të plotësohet.

Në raportin e tij, z. Ahmeti theksoi se shkatërrimi i materialeve të ndjeshme zgjedhore nga Zgjedhjet Lokale të mbajtura në vitin 2021, ka qenë paraparë që të zhvillohet gjatë muajve mars-maj 2022. Sekretariati, ka zhvilluar procedurën e prokurimit për këtë aktivitet për të përkrahur këtë aktivitet, në selektimin e materialeve të cilat janë ruajtur me kërkesë të Prokurorisë së Shtetit (PSh), PZAP dhe KQZ-së, si dhe sistemimin e materialeve nga proceset tjera zgjedhore 2013-2021. Veç komisionit mbikëqyrës për shkatërrimin e materialit zgjedhor që përfshinë edhe ZLKZ-të, janë angazhuar edhe ekipe me mëditje. Procesi i shkatërrimit të materialit të zgjedhjeve, ka filluar me 09 shtator 2022 dhe ka përfunduar në fillim të muajit tetor 2022. Nga 2485 vendvotime të rregullta, materialet zgjedhore nga 281 vendvotime apo 11.31% janë ruajtur për hetime, sipas kërkesës së Prokurorisë së Shtetit, PZAP dhe KQZ.

Duke raportuar lidhur me aktivitetet e KQZ –së në planin e jashtëm, z. Ahmetaj e informoi KQZ-në se Sekretariati i ish ACEEEO ka marrë letra mbështetëse nga nëntë (9) organizata evropiane të trupave

menaxhuese të zgjedhjeve (TMZ) dhe katër (4) organizata që nuk kanë qenë pjesë e ish organizatës. Për më tepër, katër (4) TMZ nuk e përjashtuan mundësinë e bashkëpunimit të ngushtë me organizatën e re dhe me padurim ndjekin procesin e formimit. Seanca e parë e cila është mbajtur me 19 tetor 2022 (takim online), dhe përfaqësues në takim nga KQZ e Kosovës ka qenë Kryeshefi Ekzekutiv. Në takimin online, tha Ahmetaj, është diskutuar dokumenti themeltar, duke u fokusuar në rregullat për themelimin, anëtarësimin dhe financimin (ftesat dhe materialet e tjera). Në takimin e parë është mbajtur një prezantim për Parimet bazë të Organizatës së re, Kriteret dhe kategoritë e anëtarësimit, procesi i pranimit, Fusha e aktiviteteve, Financimi dhe Rregullat për themelimin. Prezantimi është berë nga ish Sekretari i ACEEEO.

Ka pasur diskutime lidhur me organizimin e punës për nismën për themelim, propozime që të ketë grupe teknike punuese mes nëntë (9) organizatave që kanë shprehur interesim për themelimin e organizatës së re dhe fokus ka qenë mënyra e ftesave, organizimi, fushëveprimi dhe financimi i organizatës.

Në vazhdim, z. Ahmetaj tha se më 5 tetor 2022, Sekretariati ka pasur vizitë nga Agjencia e Shtetërore e Arkivave të Kosovës- ASHAK, përkatësisht Kryeinspektorja e Arkivit të Kosovës, dhe nga takimi është rekomanduar Sekretariati që të hartojë Skemën e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare sipas Stukuarës Organizative. Në lidhje me këtë me qëllim të zbatimit të rekomandimeve, Sekretariati ka hartuar dhe miratuar Skemën e Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare sipas Stukuarës Organizative, duke u bazuar në Rregulloren 01/2017, ku janë të listuara departamentet. Sipas skemës së re organizative, vendimet e KQZ-së kanë numrin **01/xxx-2022**, kurse vendimet e Kryeshefit: **02/xxx-2022**.

Ndër aktivitetet e rëndësishme të Sekretariatit, u tha se është në përgatitje plani preliminar i prokurimit për vitin 2023; Sekretariati po ashtu, është në fazën e finalizimit të plotësim-ndryshimeve të Rregullave Zgjedhore, përgatitjes së strukturës organizative të ZRCKFSP dhe pritjet të fillojë punën për ndryshim—plotësimin e rregullave të ZRCKFSP në përputhje me ligjin që ka hyrë në fuqi me 20 shtator 2022.

Në fund të raportit të tij, z. Ahmetaj tha se Sekretariati së shpejti e formon Komision për Inventarizimi i pasurisë jo financiare, para përfundimit të çdo viti fiskal me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare duke iu referuar regjistrin të pasurisë.

Në kontekst me raportin, z. **Arianit Elshani** diskutoi lidhur me shqyrtimin e rregullave – zyrës organizative të zyrës së partive. Ai, tha se duke u shqyrtuar rregullat, procesi i rekrutimit të filloj në muajin janar – shkurt 2023, prandaj edhe të hartohet një agjendë për muajt e mbetur të këtij viti dhe të merren strikt me rregulloret e brendshme në mënyrë që, edhe procesi i rekrutimit të të zhvillohet me kohë...

Elshani, diskutoi edhe rreth raporteve që duhet të bëhen dhe të shfrytëzohen nga vizitat jashtë vendit, në mënyrë që të merren dhe shfrytëzohen mësimet, përvojat dhe e gjithë konsonanca që mund të jetë përfituar nga vizitat e realizuara...

Alim Rama, tha se, ka qenë një kërkesë që me pas një raport lidhur me analizën e strukturës, kur raporton eksperti i OSBE-së në lidhje me këtë çështje...!

Kreshnik Radoniqi: Nuk ka raport të shkruar, nuk e kanë hartuar ende raportin...

Alim Rama: Ne ua kemi besuar këtë punë, dhe ne duhet të reagojmë lidhur me këtë, tek e fundit, ne jemi kontaktuar dhe ne qe një vit kemi besuar që ky raport ekziston...Dhe tash mbas dy vite me na thanë se nuk është bërë, kjo është diçka tjetër...!

Kam një çështje tjetër në lidhje me pozitën e drejtorit, në procesverbal ku nuk është shkruar drejtë dhe fjalia e ka humbur kuptimin sepse, ne kemi thënë që “këshilli është dakoduar që të respektohet ligji sa i përket ri sistemimit të ish drejtorit”, mirëpo si KQZ nuk kemi pasur dakordim se ku...! Ama, ka qenë një kërkesë që personi nuk mundet me u kthye në pozitën udhëheqëse dhe krye shefi, nuk na ka njoftuar që ai e ka marrë përsëri pozitën udhëheqëse të drejtorit...Kjo i bie që dikush që ka falsifikua dokumente, është shpërblye me pozitë dhe krye shefi i ka dëgjuar të gjitha vërejt...

Këtu, ne japim një shembull shumë të keq, tha z. Rama.

Sami Kurteshi, tha se i bashkëngjitet këtij konstatimi të z. Rama sepse, kjo mundet me pas pasoja..! Në mbledhjen e 4 tetorit ne kemi kërkuar një informatë lidhur me veprimet e gjykatave dhe prokurorive, por tash është bërë një muaj dhe nuk kemi informacion çka ka ndodh, nuk kemi dokumentacion...Unë kam interesim t'i shoh veprimet si janë ndërmarrë, çka ka ngja...! Sepse, në fund është mirë ta kemi një raport konkret, një analizë, një pasqyrë që na shërben...

Ilir Gashi, tha se është mirë të përgatitet plani i punës për vitin e ardhshëm, paraprakisht përgatitja e strategjisë sepse, plani përgatitet mbi strategjisë...Ne, duhet ta rishikojmë edhe planin e këtij viti për të parë se sa është përmbushur, po ashtu edhe përfundimi i rregullores...

Atë që e tha z. Rama lidhur me çështjen: ndoshta kryetari duhet t'i sjellë dokumentet e falsifikuese, një dokument apo më shumë dhe, ta mbyllim këtë çështje... Ndërsa lidhur me sistemimin, e përcakton ligji dhe ne s'kemi pse të merremi me këtë çështje, por është mirë që këtë çështje ta mbyllim...

Sami Kurteshi: Kolegu po kërkon me sjell dokumente, po le të sillen krejt dosjet dhe jam dakord me këtë...Por, kështu është thënë prandaj, unë pajtohem plotësisht...

Kreshnik Radoniqi: Vepra penale që dyshohet se është krye nuk është falsifikim, është deklarim i rremë...! Nuk ka dokument të falsifikuar, dhe unë ndryshe nuk di si me shpjegua... S' merremi ne me këtë punë më tutje, unë e kam adresue... Brenda institucionit, personi nuk ka asnjë procedurë, ne kemi vepruar për shkak të një dyshimi...Ndaj zyrtares, janë masat disiplinore, por edhe kjo është çështje e komisionit disiplinorë... Rasti është referuar, nuk është heshtur...! Ky është ligji... Sa i përketë ri sistemimit, kryeshefi i ka pasur dy mundësi, dhe asht vendosur në pozitën që ka qenë, kjo është... Kjo është, dhe po e përmbylli...këto janë faktet, tha kryetari Radoniqi.

Sami Hamiti, tha se kryetari e sqaroi edhe atë që desha të them, ishte një sqarim i mirë dhe, ta përmbyllim këtë...

Sami Kurteshi tha se, mendoj që kërkesa me sjellë dosjen është e drejtë, por një po e them: është konstatuar diçka por që nuk është konstatuar asgjë...Ky fjalorë e qon këtë institucion në gjendjen ku është...! Ky është problemi im, pra ka diçka dhe nuk ka kurrgjë, është ba diçka dhe nuk është ba asgjë...! Unë, e konsideroj vetën të mashtruar dhe, dosjen kemi me kshyrë...!

Arianit Elshani, tha se nuk e di se KQZ ose Këshilli nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me çështjen, ka dyshim por, sistemi i personit ka ndodhë për shkak të hyrjes së ligjit në fuqi. Pra, janë dy çështje tërësisht të ndara...

Alim Rama, tha se po, ka një veprim të gabuar, mirëpo “unë po i kthehem një çështje për të cilën më herët kam raportuar: pozitave të lira në Sekretariat”. Ato janë: Udhëheqësi i QNR-së, Dejtari i Departamentit për Çështje Ligjore, Dejtari i Departamentit të Koordinimit në Terren, Zyrtari i Lartë Komunal në Mamushë, në Lipjan, dhe Zyrtari i Lartë për Financa. Janë edhe disa pozita tjera që nuk janë të përfshira në buxhet: Zyrtari i Lartë Financiar, Ligjor, i Trajnimit, i Zhvillimit të Programit, i të Hyrave dhe dhe Fondeve të Partive Politike, Asistenti i Logjistikës dhe Përkthyesi Shqip-Anglisht.

Vërejtja ime ke se ka një konstatim që ka një vërejtje rreth drejtorit, dhe kryesuesi e ka njoftuar hetuesinë, e pa definuar ngjarjen qëndroj pas asaj. Dhe vendimi që i jepet një përgjegjësi e lartë, dhe ne po japim një sinjal që askush këtu nuk mund të ngritët pa dallavere...

Burim Ahmetaj, tha se sa u përket vendimit të gjykatave, është konfirmuar nga zyra ligjore se dokumenti është gati, dhe në mbledhjen e ardhshme do ta prezantojmë lidhur me vendimet e marra...

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të Planit të Punës së KQZ-së për periudhën Janar – shtator, 2022:

Arianit Elshani, tha se këshilli e ka shqyrtuar raportin lidhur me aktivitetet e kësaj periudhe. Në këtë aspekt, nga 54 aktivitete të planifikuara janë realizuar 22, dhe kjo është 38% e realizimit të planit.

Ai pastaj, shpjegoi disa prej planeve të cilat, janë varur nga KQZ dhe se prolongimi i tyre ka ardhë si rezultat i kohës së trajtimit të tyre...

Kreshnik Radoniqi: E hedh në votim, kush është për miratim ?

Me 10 vota për, miratohet raporti i Planit të Punës së KQZ-së për periudhën Janar – shtator, 2022

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës gjinore dhe moshës së lidërshipt të partive politike 2017-2021:

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar edhe analizën gjinore të moshës së lidërshipt të partive politike në periudhën 2017-2021, dhe kjo është hera e parë që ne kemi bërë një analizë të këtillë ! Këtu, janë të dhënat lidhur me përfaqësimin gjinorë nga subjektet politike në organet e larta vendimmarrëse, i moshës etj. Prej 3 089 personave të listuara, përmes tabelave shihet se 700 persona janë femra, dhe të tjerët meshkuj. Pra, është një analizë e mirë, e nevojshme, një pasqyrë...

Nuk ka qenë e lehtë përgatitja si për shkaqe teknike, po ashtu edhe për shkak të konfirmimit, përdorimi i materialeve etj.

Në këtë pikë, diskutoi Ibrahim Selmanaj, Sami Kurteshi, Alim Rama, Vesa Xharra, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Fazli Stollaj dhe Kreshnik Radoniqi.

Në fund të shqyrtimit të kësaj pike, pas diskutimeve të gjata anëtarët e KQZ-së konstatuan se ka nevojë që ky material të përpunohet ende, të verifikohet, të plotësohet me të dhëna të tjera të krahasueshme, dhe sidomos me verifikimin dhe plotësimin e statistikave etj.

Kryetari Kreshnik Radoniqi, konstatoi në fund që kjo pikë të tërhiqet, dhe të silllet në një moment tjetër pas analizës së bërë. ..

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-Shtator 2022:

Gordana Llaban: E kemi mbajtur takimin e 12 të këshillit, dhe kemi pasur katër pika në rend të ditës, por mendoj që më me interes ka qenë pika e shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-shtator 2022. Raportin e keni pasur në imell, dhe shpresoj ta keni lexuar.

Pastaj, anëtarja Llaban, paraqiti shkurtimisht disa të dhëna nga raporti.

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi**, i cili pyeti nëse ka ndonjë rekomandim në raport. Kurse, **Alim Rama** tha se raporti, është bazik dhe transparent... Ndërsa, **Sami Hamiti** tha se problemi qëndron te rregullimi i udhëzimit administrativ, ndërsa që raporti është i plotë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të raportit ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë raport.

Të ndryshme !

